

Ta bëjmë Steblevën më të bukur, më të gjelbëruar dhe më të begatë

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.14. Maj 2009.

Çmimi 50 lekë.

Editorial

Pyjet e brendshme të Steblevës kanë qenë dhe janë pronë private

Kryesisë së Shoqatës "Stebleva" i është kërkuar që të bëjë kallëzime penale për personat që kanë dëmtuar pyjet e dushkut (zabelet e brendshme të fshatit) në Steblevë. Ju sqarojmë se edhe territori i fshatit Steblevë është pjesë e parkut Kombëtar të miratuar nga qeveria. Për çdo steblevas dihet se përdorimi tradicional i këtyre pyjeve është bërë për ushqimin e bagëtive dhe për dru zjarri (vetëm lisat e degraduar). Çdo lloj shfrytëzimi jashtë këtij destinacioni është abuziv. Edhe në mbledhjen e fundit të shoqatës u vu theksi të shkatërrimi i pyjeve të brendshme të fshatit tonë nga persona konkret. Personat që kanë firmosur në Komunë si përfaqësues të komunitetit nuk e kanë këtë të drejtë, prandaj nga Kryesia kërkohet me forcë që të respektohet ligji për të mbrojtur pyjet dhe tradita për shfrytëzimin e tyre. Pyjet tona të brendshme janë pasuri private brez pas brezi.


Hazis Lila, delegat i Kongresit të Manastirit dhe i aktit të pavarësisë

Fakte dhe dokumente të reja

FAQE 4



Në foto: Mithat Frashëri, Gjergj Fishta, Nikoll Kaçorri, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Feim Zavalani, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Rrok Berisha, Bajo Topulli, Thoma Avrami, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, Akil Eftimi, Adham Shkaba, Dhimitër Buda, Mati Logoreci, Hazis Lila, Shefqet Frashëri, Simon Shuteriqi, Leonidha Naçi, Zenel Glina, Sami Pojani, Refik Toptani, Mihal Grameno, Çerçiz Topulli, Myftar Axhemi (shok i Çerçizit), Roja i klubit "Bashkimi" dhe një luftëtar nga Elbasani



Origjina e Ataturkut, Stebleva e Dibrës

Prof. Çabej: Nëna e Ataturkut është nga Sebishti i Dibrës

Fakte dhe dokumente të reja

Studiuesi Ramazan Hoxha nga Stebleva: Mustafa Qemal Ataturku është biri i një nëne nga Sebishti ndërsa i jati ka qenë nga Stebleva. Ata janë larguar në emigrim në Selanik në vitin 1861 dhe më 11 mars 1881 ka lindur Mustafa Qemali. Tokat e tyre në Steblevë janë edhe sot, tokat e Conkajve poshtë malit të Osojit. Vetëm për të ndërtuar çezmën në vendin e quajtur Terzicë, Mustafai kur u bë gjeneral dhe udhëheqës i Turqisë moderne ka paguar dy qese me flori.

Origjinën shqiptare dhe dibrane të Ataturkut e ka deklaruar edhe ciceroni turk në ekspozitën e vitit 1984 në Tiranë kushtuar Ataturkut. Në këtë ekspozitë ka qenë e vizatuar edhe pema e gjenezës së Ataturkut.

Historiani dhe gjuhëtari Ali Hoxha nga Çidhna: Jam dëshmitar në një seminar të gjuhësisë në Peshkopi në vitin 1978 kur Prof. Eqrem Çabej, bashkëkohës i Ataturkut, ka deklaruar: "Nëna e Mustafa Qemalit është nga katundi Sebisht i Dibrës...". Ataturku krenohet që ishte dibran.



Në këtë numër do të lexoni

Veprimtari të shoqatës "Stebleva"

FAQE 2

Steblavasit, tregëtarë të sprovuar

Nga Iljaz BANDE

FAQE 2

STEBLEVA, e besës, mikpritjes dhe e punës vetmohuese

Nga Muhamed KALAJA

FAQE 3

SELMAN MERSA inxhinjer, projektues dhe sipërmarrës i shquar

Nga Osman ULIU

FAQE 4

Si mbijetuam në ato vite të vështira lufte

Nga Ferit PIRUSHI

FAQE 6



REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA"

Drejtor: Mersin Hoxha/ Redaktorë: Halil Kurti, Asjap Gruda, Artan Lila, Reshat Gruda. Kryeredaktor: Sakip Cami

VEPRIMTARI TË SHOQATËS "STEBLEVA"

Takim me Kryetarin e Këshillit të Qarkut të Elbasanit Ardian Turku, i emëruar kohët e fundit ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Zoti Turku ka miratuar një projekt prej 34 mijë dollarësh për përmirësimin e 400 ha pyjeve të Steblevës

Me datë 14 janar 2009 një përfaqësi e Shoqatës "Stebleva" e përbërë nga zotërinjtë Mersin Hoxha, kryetar i shoqatës dhe Hajredin Kurti u takua me kryetarin e Këshillit të Qarkut të Elbasanit zotin Ardian Turku.

Zoti Mersin Hoxha e njohu zotin Ardian Turku me përbërjen dhe objektivat e shoqatës "Stebleva" që ka mbi 2000 anëtarë. Në këtë shoqatë

janë jo vetëm 300 familjet e hershme të këtij fshati me tradita, por edhe të gjitha familjet e shpërngulura dhe që banojnë brenda dhe jashtë vendit.

Shoqata publikon edhe gazetën e saj "Stebleva" ku trajtohen problemet e saj shqetësuese për pronat, tapitë, kufijtë e tokave, pyjeve dhe kullotave, për traditat patriotike dhe kulturore, për zgjidhjen e problemeve ekonomike etj.

Ndodh shpesh herë, theksoi Mersin Hoxha, që persona përfaqësues të shtetit, e identifikojnë Steblevën me Fushë-Studënin dhe nuk e kanë kaluar Fushën e Studnit.

Zoti Ardian Turku pasi u njoh me problemet premtoi se këto shqetësime do të zgjidhen. Kryesia e Shoqatës nga ana e saj i uron zotit Ardian Turku suksese në detyrën e re të ministrit.

Koresp. "Stebleva"



Dëmtimet e pyjeve në Steblevë do të marrin fund

(Nga takimi me nënprefekten e Librazhdit Mimoza Qyra)

Një grup i kryesisë së Shoqatës "Stebleva" i përbërë nga z. Mersin Hoxha kryetar i shoqatës dhe Hajredin Kurti zhvilluan një takim me nënprefekten e Librazhdit Znj. Mimoza Qyra lidhur me shqetësimet e fundit në zonën e Steblevës dhe në Parkun Kombëtar. Në takim mori pjesë edhe drejtori i Ndërmarrjes Pyjore të rrethit të Librazhdit.

Në takim u shtrua problemi i pyllit të Përroit të Govatave, për të cilin akoma drejtorja e pyjeve të Bulqizës ka akses kontrolli dhe pronësie. Ky pyll, si të thuash, ka mbetur midis dy drejtorive, ku asnjëra nuk e mbron, por e dëmtojnë brutalisht.

Po kështu edhe pyjet e ulta dhe ahishtet në fshatin e Steblevës po dëmtohen nën pretekstin e shfrytëzimit me leje të paqena, ku edhe vetë kryetari i komunës është i përfshirë në këto shfrytëzime korruptive, në një kohë që këto pyje nuk

janë pyje komunalë dhe e tërë zona është shpallur Park Kombëtar dhe mbrohet nga shteti me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë park janë shfrytëzuar jo pak por 2000-3000 metra kub dru nëpërmjet një leje abuzive të z. Rexhep Kurti

Gjithashtu u shtrua edhe problemi i dëmtimit të faunës së zonës dhe zhvillimit të gjuetisë së ndaluar ku po zhduken specie të rrallë të kafshëve të egra.

Drejtorja e Pyjeve Librazhd mori përsipër zgjidhjen e këtyre problemeve dhe shqetësimeve, por njëkohësisht kërkoi forcimin e bashkëpunimit midis Policisë së Rendit, policisë kufitare dhe asaj pyjore. Në lidhje me ecurinë e rrugës Librazhd-Steblevë, zonja Mimoza theksoi se punimet kanë ecur deri në Qafën e Drizës dhe se do të vazhdojnë me sukses edhe në

ditët në vijim. Kryesia e Shoqatës e falenderoi zonjën Mimoza për predispozicionin e saj.

Koresp. Stebleva

Nga analiza e veprimtarisë së shoqatës për vitin 2008

KEMI EDHE SHUMË PËR TË BËRË

Me datë 21 dhjetor 2008 tek Lokali i Abib Kormakut u bë një takim i shoqatës "Stebleva" ku u analizuan problemet dhe arritjet e shoqatës gjatë kësaj periudhe. Pjesëmarrja e komunitetit të Steblevës ishte e kënaqëshme, por duhet të ishte edhe më e madhe, sepse shoqata është vendi ku diskutohen dhe zgjidhen problemet dhe shqetësimet tona. Gjatë periudhës mars-dhjetor 2008 dolën shtatë

numra të gazetës "Stebleva" ku u publikuan dhjetra shkrime nga autorë steblevas, u publikuan dhjetra figura historike të Steblevës, u trajtua problemi i pronave dhe tokave dhe u bënë disa takime me pushetarët qendrorë dhe vendorë. Kemi edhe shumë për të bërë për ta ngritur edhe më lart emrin e Steblevës dhe për të zgjidhur problemet që na shqetësojnë, theksuan diskutantët. Të marrim pjesë të

gjithë, të diskutojmë e të jemi aktivë, për tu bërë një komunitet model për të gjithë Shqipërinë. Pjesëmarrësit që diskutuan ngritën probleme dhe premuan se do të jenë edhe më aktivë në zgjidhjen e çështjeve të shoqatës. Kryetari i Shoqatës Mersin Hoxha kërkoi kontributin e të gjithë anëtarëve të shoqatës, kontribut financiar dhe aktivizim edhe më të madh.

Koresp. "Stebleva"


STEBLEVA, KRYQËZIM I KORRIDORIT TË VIII DHE TË X NDËRKOMBËTAR

(Vendet e interesuara si Italia, Bullgaria dhe Maqedonia mbledhen në Tiranë për të diskutuar për projektin e Korridorit VIII)

Projekti madhor i Korridorit të VIII ka bashkuar në Tiranë deputetët e Komisioneve të transportit dhe të industrisë të Shqipërisë, Italisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë, me pjesëmarrjen e Trupit diplomatik, organizmave ndërkombëtarë dhe ekspertëve të kësaj fushe.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë Jozefina Topalli vlerësoi se Korridori VIII është rruga e integritit të rajonit si dhe njëkohësisht rruga e krijimit të një hapësire ekonomike europiane dhe se ky takim është një hap përpara për përshtetimin e këtij projekti madhor.

Përveç rrugëve një interes të madh përbën edhe gazsjellësi Gazprom që do të furnizojë vendet e Ballkanit Përdimor me gaz si dhe do të heqë varësinë ekonomike dhe të naftës të vendeve të Europës Përdimore dhe Qëndrore nga vendet aziatike.



Përveç Shqipërisë nga ky projekt përfiton edhe shteti më i ri i Europës, Kosova.

Siç e kemi thënë edhe në shkrimet e tjera Stebleva, që ndodhet në kryqëzimin e këtyre 2

korridoreve, përbën një nyje ekonomike, për të cilën duhet të mendojmë që tani për të zhvilluar infrastrukturën rrugore, turistike dhe arsimore si dhe për të parapërgatitur opinioin dhe njerëzit.

Koresp. Stebleva.

STEBLAVASIT, TREGËTARË TË SPROVUAR

Steblevasit gjithmonë kanë qenë të dëgjuar për tregëti. Thuhet nga më të vjetërit se steblevasit me kuajt e tyre kanë bërë tregëti duke transportuar kripë e mallra të tjera nga Elbasani dhe nga Durrësi për në Dibër të Madhe, Strugë dhe Ohër.

Bashkëfshatarët tanë në Elbasan, Tiranë, Durrës, Kavajë, Strugë, Ohër, Shkup, Stamboll etj kanë patur gjellëtore, byrektore, pastičeri e dyqane të tjera të të gjitha llojeve.

Daja im Shaban Nura kujton se kur ka qenë 14 vjeç dhe ka punuar tek Ndërmarrja

"Muhamet Gjollësia" nuk numërohejshin gjellëtoret që kanë patur steblevasit. Dhe ai kujtonte: Mehmet Çausi (Baushi), Hajdin Baushi, Nuredin Kurti, Rifat Çausi, Iljaz Gruda, Hamit Abazi, Shaban Kuçuku, Rifat Gjerani etj. Po në Tiranë kanë patur pastičeri: Osman Hoxha, Sefer Avda, etj.

Në Durrës kanë patur gjellëtore Baftian Disha, Xheladin Rade, Ramadan Agushi, Ibrahim Avdiu, Mexhit Bajra, Ferat Çausi etj. Në Elbasan kanë patur gjellëtore: Liman Idrizi, Murat Idrizi etj. Mustafa Hoxha ka pa-

tur dyqan në Korçë qysh gjatë viteve të Luftës së II Botërore.

Steblevasit kanë patur dyqane dhe aktivitet tregëtar edhe jashtë kufijve të sotëm të shtetit shqiptar si në Maqedoni, Turqi etj.

Pra steblevasit kanë një traditë të vyer tregëtare. Ata e kanë të trashëguar në gene tregëtinë, komunikimin me blerësit, menaxhimin etj.

Kështu ata i kanë shërbyer vehtes edhe fshatit ku kanë lindur dhe janë rritur duke transmetuar një përvojë brez pas brezi.

Të shumtë janë edhe tregëtarët e sotëm që kanë ecur

dhe ecin në fushën e tregëtisë, që sjellin zhvillim e mirëqenie për mbarë kombin.

Gazeta e shoqatës sonë "Stebleva po del rregullisht falë kontributit të biznesmenëve steblevas dhe e kryetarit të shoqatës Mersin Hoxha, gazetë e cila po shkruan për traditat tona dhe për kontributin e të gjithë steblevasve kudo që ndodhen.

Ndoshta do të duhen libra për të pasqyruar punën e madhe të komunitetit steblevas kudo që ndodhet dhe që do të jetë objektivi i së ardhmes.

ILJAZ BANDE

STEBLEVA, e besës, mikpritjes dhe e punës vetmohuese



Nga Muhamed KALAJA*

Tek shëtisja një ditë janari në një rrugë të Tiranës së re, aty afër "Tajvanit" takoj një mikun tim nga Stebleva. U përqafova fort me njëritjetrin tërë mall, sikur edhe unë të kisha lindur atje, në atë fshat të bukur me burime të ftohta, me male të lartë e pyje pa mbarim, ku dëborë nuk shkrin e tëra në pjesën më të madhe të vitit.

U futëm në kafënë që kishim pranë e nisëm një bisedë të shtruar rreth punëve tona të përditshme. Mua filluan të më ngacmojnë ato kujtime të largëta nga ai fshat i bukur me klimë të ashpër, por me njerëz puntorë e të urtë, që përballonin vështirësi të mëdha si nga pikpamja ekonomike, por edhe të motit që nuk e kursente dëborën nga vjeshta deri në fundin e pranverës.

Bisedën ma stimulonte edhe miku im, që ushqente një dashuri të madhe për fshatin e tij që i buronte nga shpirti e zemra. Megjithëse kane kaluar 35 vite nga ajo kohë, në trurin tim është fiksuar si në ndonjë film i xhiruar me kamera moderne, gjithçka që përjetova atje, vështirësitë e mëdha që kalova atë dimër në Steblevë si dhe dashuria e madhe e atyre njerëzve të thjeshtë, punëtor të palodhur e mjaft mikpritës.

Falë Zotit dhe trurit, këtë organ material, sa hyjnor, aq edhe të mrekullueshëm kam mbajtur atje thëllë-thëllë, në pjesët e pasme të tij, në ato honte të vogla ku çdo gjë ruhej e sigurt dhe nuk mund të depërtonte asgjë tjetër që ta fshinte atë çka kisha përjetuar atje e sot vetiu po mi çfaqte si relike të vjetra e të çmuara për ti bërë pjesë e të gjithëve.

I. Si e mbaj mend Steblevën e atyre viteve

Ishte viti 1972 e kisha shkuar atje për të kryer shërbimin ushtarak. Në atë kohë në Steblevë ishte një bataljon

(Mbresa)

mitralier si brez i dytë për mbrojtjen e kufirit me ish Jugosllavinë.

Në brigadën e këmbësorisë në Librazhd kisha bërë betimin ushtarak e isha caktuar në kompaninë e ndërlihdjes. Në atë kohë u zhvillua një kurs për radio-telegrafist e gjatë stërvitjes isha shquar si radio-telegrafist i mirë. Shkëlqimi, një shoku im tiranas ato ditë më tha se e kisha siguruar qëndrimin aty në shtabin e brigatës, ndërsa ne të tjerët do të hanim dynjanë, do të shpërndahehim në bataljone.

Në komandën e brigadës ishin marrë vendime që radistët më të mirë të shpërndahehim në bataljone që ishin në distancë të largët nga brigada. Mua bashkë me shokun tim nga Picalla, Gëzim Qershori, më caktuan në Steblevë, një emër ky i padëgjuar deri atëherë. Kështu në muajin nëntor 1972 njoha për

madje punonin gjithë ditën e ditës. Disa punonin në stabilimentin e sharrave aty afër, të tjerë merreshin me punët e bujqësisë. Punonin të gjithë, burra, gra e fëmijë.

Ishin të lidhur fort me njëritjetrin. Ky që ndoshta sekretit që përballonin çdo vështirësi që u dilte përpara. Lëvizjet bëheshin me mushka e kuaj, ndërsa mbanin veshur çizme, kur zbrisnin nga kafshët ecnin me ski.

Tërë ditën fëmijët në kohë të lirë luanin me ski. Më shumë se të tërë në punë shquheshin gratë e vajzat, të cilat merreshin me punët brenda shtëpisë dhe jashtë saj, me gjithçka. Ato nëna të dashura që rrisnin fëmijë të shëndetshëm, të cilëve u skuqnin faqet e kuqe që larg, kishin një zemër të madhe, të bardhë si dëborë. Shpesh na sillnin qumësht apo pastërma që ishte një zaire të cilën ato e për-

njerëzve dhe kujdesi i madh që tregonin oficerët e nënoficerët atje më kënaqën më shumë se sa në brigadën e Librazhdit.

Nuk do të harroj kurrë oficerët e talentuar, komandantët Zydi Kroj, Etem Merkuri, oficerët Medi Laze, Fatmir Abazi e Nezhdet Ago, nënoficerin Agim Kurti e të tjerë të cilët bënë çmos të demokratizonin sado pak jetën e brendëshme në batalion. Frymëzimi i atyre njerëzve të mrekullueshëm më bënë që unë të shkruaj atje poezitë e para, artikujt e parë në gazetën "Zeri i Rinisë" e "Luftëtari" të asaj kohe.

Në kohën e lirë luanim volejball, basketboll. Jo rrallë dilnim për gjah. Kafshët e egra që vriteshin gatuheshin për ushtarët. Lidhjet midis popullit e ushtrisë ishin mjaft të forta. Asnjë ngjarje e jashtëzakonshme s'kishte ndodhur ndonjëherë.

Shpeshherë mblidheshim e festonim bashkarisht ngjar-

kanë kaluar 35 vjet nga ajo kohë përsëri e kujtoj me mall atë fshat të bukur, ndonëse me klimë të ashpër, të cilën njerëzit që banonin e banojnë duke sikur e zbutnin. Natyra e bukur e atij fshati i kishte të pa kursyer thesaret, por thesare më të mëdha pa dyshim mbeteshin njerëzit.

Ata ishin në kontrast të plotë me klimën e ashpër, njerëz të urtë, të duruar, guximtarë, mikpritës e me zemër të gjërë. Kështu janë skaltur e do të mbesin gjithnjë ata në kujtesën time.

II. Pas 35 vjetësh në Steblevë.


Nga pikëpamja e njerzillëkut, e atyre traditave të vyera që përmendëm më lart stëblevasit kanë mbetur po ata njerëz të thjeshtë, të urtë e punëtor të palodhur, kanë ndërtuar shtëpi të reja e kanë zburuar më shumë fshatin e tyre. Traditat e bukura të mikpritjes, dashuria për mikun, unitetin me njëritjetrin në rast gëzimi e fatkeqësisë i kanë përcjellë brez pas brezi.

Emigracioni ka prekur edhe Steblevën. Të parët qenë ata që u larguan për të fituar më shumë, por ajo që i dalton të rinjtë e Stëblevës nga disa të tjerë është dashuria për fshatin e tyre. Ato punojnë në emigracion në vende të ndryshme të botës si Greqi, Itali e gjetkë dhe ia dinë vlerën parasë, me kursimet e tyre ato kthehen në fshat e kontribuojnë në zburimin e Steblevës.

Janë ato emigrantë që dinë seç është vështirësia, si fitohet leku e si duhet shpenzuar ai për të mirën e familjes së tyre e të komunitetit. Gjatë kohës kur edhe unë isha në emigracion në Greqi takoja shpesh stëblevas dhe më dukeshin më të afërt se sa bashkëfshatarët e mi. Ja keto janë stëblevasit sot. Punojnë kudo, brenda e jashtë vendit, por mendjen e kanë pas, tek fshati i tyre që zburkohet çdo ditë. Ndërsa unë duke përfunduar këto mbresa mendoj se kam shlyer një pjesë të vogël të atij borxhi të madh që u detyrohesha atyre njerëzve.

Ndaj sot vetiu më buron nga zemra urimi: "Qofshi të nderuar e të respektuar në shekuj, kurdoherë të lumtur e krenar për Steblevën.

***Muhamet Kalaja është poet dhe publicist nga Ndroqi i Tiranës**



herë të parë Steblevën. Mbaj mend që fshatin e kishte mbuluar dëborë që vazhdonte të binte pa pushim. Tek udhëtoja nga Fushë-Studna, për të arritur në Steblevë frynte një erë që të zinte frymën. Njerëzit lëviznin me mushka e kuaj. Majë mushkave shikoja për herë të parë disa gra të forta të ngarkuara me dru që bënë edhe triko për fëmijët, të cilët më kujtonin ato gra të forta që përshkruan Balzaku në romanet e tij.

Kudo syri të zinte bardhësi, ahishte të larta e gjithfarë drurësh të tjerë të zbardhur nga dëborë. Temperatura arinte minus 25-30 gradë C. Njerëzit visheshin me peliçe e veshje të tjera leshi, ndërsa kokën e një pjesë të fytyrës e mbulonin me kokore leshi.

Moti në Steblevë që mjaft i egër, por njerëzit qenë më të fortë dhe e përballonin atë,

gatisnin për dimrin e ashpër. Patatja e kuqe e ruajtur mirë në kavaleta si dhe pastërmaja ishin ushqime bazë të banorëve, bashkë me bulmetin. Njerëzit megjithëse jetonin në kushte të vështira ishin të shëndetshëm..

Mbaj mend se shpesh gra e fëmijë vinin në centralin ku unë isha me shërbim e mernin në telefon burrat, djemtë, apo të afërmit e tyre që në ato vite punonin në ndërtim në Tiranë. Pothuajse tërë ish Ndërmarrjen e Ndërtimit të asaj kohe e dominonin stëblevasit, ata punëtorë duarartë e mjeshtër të zot të punimit të gurit, karpentjerë e muratorë të talentuar që nuk i gjeje kollaj në Shqipëri.

Të them të vërtetën në fillim u mërzi shumë kur më caktuan në Steblevë, por shpejt dashuria e këtyre

je të shënuara. Mikpritja e stëblevavse që e madhe ashtu si e tërë dibranëve.

E kush nuk ka dëgjuar në Shqipëri për sofrën dibrane. Aty vendosej institucioni i besës, aty bëhej edukimi i të rinjve, përcillej gjithçka e bukur shqiptare nga brezi në brez. Sofra dibrane ishte me plot kuptimin e fjalës një shkollë e madhe për të hyrë në jetën e vërtetë, në jetën reale me plot probleme e sakrificë.

E pse ta fsheh, edhe unë i riu nga Tirana i asaj periudhe i mora aty mësimet e para të kalitjes me vështirësitë. Mu forcua durimi, karakteri, guximi e dashuria për njerëzit e punës.

Dua të them se Stebleva që një shkollë e vërtetë e jetës sime që u reflektua më vonë në tërë veprimtarinë time kudo që punova. Megjithëse

HAZIS LILA, (HOXHË LILA), DELEGAT I KONGRESIT TË MANASTIRIT DHE I AKTIT TË PAVARËSISË

Hazis Lila, ose siç njihet nga shtypi kohës Hazis Efen-di u lindi në Steblevë të Dibrës në vitin 1975 në një familje të mesme fshatare me tradita patriotike. Mësimet e para në shqip dhe turqisht i mori në fshatin e tij nga Imer Hoxha, i cili përveçse kryente shërbimet fetare në xhami si hoxhë, jepte mësim në Mejtepin e fshatit në gjuhën turke dhe fshehurazi edhe gjuhën shqipe nëpërmjet një abetareje që e kishte futur në Shqipëri që në vitin 1890 patrioti Dervish Zharri nga Berzeshta.

Studimet e mesme i kreu në Selanik. Studimet e larta i kreu në Stamboll për teologji. Pasi kreu me sukses studimet e larta për teologji u specializua për filozofi dhe astrologji në Francë. Ai ishte njohës i shkëlqyer i arabishtes, turqishtes, persishtes dhe frëngjishtes.

Mbasi mbaron studimet në Francë, kthehet në Shqipëri në moshën 30 vjeçare dhe emërohet profesor për gjuhën turke në Gostivar dhe më vonë drejtor i shkollës së mesme turke në Dibër të Madhe. Në këtë qytet ai njihet dhe futet në veprimtari të përbashkët me Vehbi Dibrën, Hoxhë Moglicën, Said Najdenin etj.

Ai bëhet anëtar i klubit "Bashkimi" të Manastirit në korrik 1908 dhe në nëntor 1908 merr pjesë si delegat i Kongresit të Manastirit, Kongresit të njesimit të gjuhës shqipe, përkrah me 50 burra të shquar të kombit shqiptar si Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Mihal Grameno, Sotir Peci, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Bajo Topulli, Gjergj Qiriazit etj.

Edhe pse ishte nëpunës i shtetit turk, drejtor i shkollës së mesme turke me titull hafuz, ai kishte përqafuar idetë iluministe franceze ku kishte studiuar si dhe idetë e rilindasve tanë. Ai është pjesëmarrës i të gjitha takimeve dhe kuvendeve për zgjim kombëtar, liri dhe pavarësi. Ai ishte anëtar i shoqërisë patriotike "Bashkim e Përparim" që ishte e përhapur pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Në kuadrin e përhapjes së këtyre ideve dhe veprimtarive ai krijoi "Grupin Patriotik të Gollobordës" me qendër në Steblevë. Ai bashkëpunoi me patriotët e zonës si Hoxhë Hasan Moglicën nga Moglica e Okshtunit, me Elez Koçin nga Ostreni, me Islam Lamën nga Stebleva, me Vasil Pleushkun nga Klenja, me Murat Qolin nga Zabzuni etj. me të cilët merreshin me organizimin e shkollave shqipe dhe përhapjen e gjuhës shqipe, shpërndarjen e librave shqip në Steblevë, Okshtun, Klenjë, Trebisht, Ostren etj. Librat shqip prodhoheshin në Stamboll nga shoqata patriotike shqiptare dhe silleshin në Shqipëri dhe konkretisht në Gollobordë nëpërmjet tregëtarëve vendas. Libra shqip vinin edhe nga shoqëritë shqiptare të Sofies dhe Bukureshtit.

Verpimtaria patriotike e Hoxhë Hazis Lilës ra në sy të autoriteteve turke, të xhon-turqve, të cilët ndonëse më liberalë se paraardhësit e tyre ndaj shqiptarëve ishin prepotentë dhe aspak tolerantë e dashamirës për lejimin e gjuhës shqipe. Ata e transferojnë Hoxhë Lilën në Ohër dhe më pas në Manastir si mësues i

thjeshtë në shkollat turke. Por ky transferim nuk e ndali aspak veprimtarinë patriotike të tij, përkundrazi e forcoi atë. Në korrik 1908 ai bëhet anëtar i Klubit Patriotik "Bashkimi" të Manastirit. Ai merr pjesë në Kongresin e Manastirit si delegat i Berzeshtës dhe Steblevës që u zhvillua nga data 14-22 nëntor 1908 dhe më vonë në Kongresin e Elbasanit më 2-8 shtator 1909, që u finalizua me hapjen e Shkollës Normale për përgatitjen e arsimtarëve të gjuhës shqipe. Së bashku me Seit Najdenin (Hoxhë Vokrrin) dhe Hoxhë Hasan Moglicën hartuan edhe planin e lëvizjes së armatosur për shporrjen e turqve nga zona e Gollobordës. Në vitin 1911 Hoxhë Lila së bashku me fshatarët dhe shokët e tij organizoi djegjen e mejtepeve turke në të gjithë krahinën e Gollobordës si në Steblevë, Trebisht, Ostren i Madh, Okshtun i Madh etj.

Në vitet 1911-1912 organizon revoltat popullore kundër pushtimit turk. Këto veprimtari finalizohen me pjesëmarrjen e tij në Vlorë më 28 nëntor 1912.

Hazis Lila do të jetë përkrah Ismail Qemalit më 28 nëntor 1912 në momentin e shpalljes së pavarësisë. Ai ndonëse nuk është firmëtar si në Kongresin e Manastirit ku kontributi i tij për gjuhën shqipe është i pamohueshëm si një nga 50 delegatët e gjithë shqiptarizms, në Vlorë përsëri roli i tij është vendimtar. Këtë e vërteton fakti që ai u emërua nga qeveria e Ismail Qemal si krahinar për gjithë krahinën e Gollobordës.

Hazis Lila kishte lidhje dhe kishte miqësi me Prefektin e



Elbasanit, Aqif Pashë Biçakun (Elbasanin). Me tu kthyer nga Vlora ai shpalli bashkimin e krahinës së Gollobordës me Qeverinë e Vlorës dhe ngriti flamarin shqiptar në krahinë. Me ndihmën e Aqif Pashës ai ngriti dhe ndërtoi administratën e krahinës në kushte tashmë terroristi sepse menjëherë pas shpalljes së pavarësisë kemi ndërhyrjen ushtarake serbe në krahinë për të depërtuar deri në Shkumbin.

Hazis Lila së bashku me shokët e tij patriotë të krahinës dhe të fshatit Steblevë kurrë nuk u pajtua me vendimin e 1913 për copëtimin e kufijve të Shqipërisë. Deri në dorëheqjen e Qeverisë së Vlorës me 22 janar 1914 ai ruajti tërësinë territoriale të krahinës duke mos lejuar copëtimin e mëtejshëm. Pas vendosjes së kufijve të vitit 1913, ushtritë serbe u përqëndruan në fshatin Llabunisht të Strugës duke pritur momentin

e përshtatshëm për të sulmuar përsëri fshatrat shqiptarë brenda kufijve të vitit 1913. Në këto kushte krahinari Hazis Lila organizoi një forcë të armatosur prej 100 vetësh të komanduar nga Ahmet Bejtaga, komandant i xhandarmërisë i emëruar nga qeveria e Vlorës.

Ai do ta vazhdojë luftën e tij të pandalur deri sa serbët e vranë më 7 qershor 1915 ku bie në pritën e organizuar nga serbët dhe masakrohet barbarisht prej tyre. Kjo vrasje politike dhe barbari u bë pikërisht në Llakavicë, në vendin ku u kundërshtuan kufijtë e vitit 1913 dhe vendimet e Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve.

Kështu mbylli sytë një nga bijtë, intelektualët dhe patriotët më të mëdhenj të Steblevës, krahinës dhe gjithë Shqipëtarisë.

R. Hoxha

STEBLEVASIT MJESHTËR DHE SIPËRMARRËS NDËRTIMI

SELMAN MERSA inxhinjer, projektues dhe sipërmarrës i shquar

(Deri vonë në rrugët e Tiranës do të gjejë kapakët e pushtave me shkrimin: "IMPRESSO MERSA MILANO, ITALIA". Firma "Mersa" kishte pushtuar edhe rrugët e Italisë.)

Stebleva është e shquar përveç të tjerave edhe për mjeshtërinë e ndërtimit si e gjithë krahina e Gollobordës. Por në dallim me të tjerët, mjeshtërit steblevas nuk ishin thjesht muratorë, por ishin ustallarë të vërtetë, drejtues, brigadierë, mjeshtra prodhimi, asistentë inxhinjerë. Ndonëse në të shumtën e rasteve u mungonte arsimit i plotë ata haheshin me të shkolluarit.

Një prej këtyre mjeshtërve të shquar ka qenë Selman Mersa.

Selmani ka lindur në Steblevë në vitin 1904. Fëmijërinë e kaloi në fshatin e tij të lindjes.

Në moshë të re ai u largua nga Stebleva dhe Shqipëria dhe u muar me mjeshtërinë e ndërtimit.

Në kohën e Mbretërisë dhe të pushtimit italian në Shqipëri ai u muar me ndërtim në vendin tonë. Por kjo nuk e pengoi atë që të ndihmonte me para dhe shërbime të tjera luftën nacionalçlirimtare. Steblevasit, thoshte shpesh Selmani, janë njerëz të zgjuar, paqësorë dhe shumë punëtorë. Ata janë ndërtesues të zotë, prandaj i kam pasur gjithmonë me vete, kudo ku kam punuar. Jam krenar që jam nga Stebleva dhe ruaj kujtimet më të mira për bashkëfshatarët e mi.

Për aftësinë e tij menaxhuese dhe talentin në ndërtim ai u bë sipërmarrës i shoqërisë



italiane që vepronte në Shqipëri AIPA

Veprat ku ka punuar dhe drejtuar Selmani janë të shumta. Ja disa prej tyre:

-Projektim dhe ndërtim

shtëpish dhe vilash në Tiranë dhe qytete të tjera.

-Menaxhimi i Gurores së Linxës.

-Ndërtimi i Medresesë dhe

Kryegjyshitës së Tiranës, vepra që edhe sot janë në lartësinë e vlerave të kohës si nga pikpamja arkitekturore ashtu edhe nga forca ndërtuese.

-Hapje, ndërtim rruge dhe veprash arti në rrugën e Krrabës, nga Tirana në Elbasan.

-Ka marrë pjesë në ndërtimin e godinave të ministrive në Tiranë.

-Ka ndërtuar objekte në firmat e naftës në Kuçovë, në kuadrin e shoqërisë italiane AIPA. Ai ka dhënë kontributin e tij për urbanizmin e qyteteve të Tiranës, Durrësit dhe Dibërës.

Ministrat e ndërtimit të kohës si Spiro Koleka, Rrahman Hanku janë këshilluar me Selmanin konkretisht në terren atje ku ndërtoheshin veprat më të vështira sepse përvoja e tij ishte shumë e vyer.

Pas çlirimit edhe Selmanit ja konfiskuan automjetet dhe mjetet e ndërtimit dhe ai vazhdoi punën në kushtet e reja të krijuara sepse kishte për të rritur jo pak por tetë fëmijë. Përveç konfiskimit të mjeteve i morën edhe 2420 metra katrollë truall dhe dy shtëpi, pikërisht në vendin ku sot është ndërtuar Shkolla e Baletit.

Në vendin ku sot është Disko-Klub Albania pranë të ashtuquajturës Gropa e Ajdin Sejdisë, Selmani ka projektuar dhe ndërtuar Mapon e Madhe të Tiranës.

Deri vonë në rrugët e Tiranës do të gjejë kapakët e pushtave me shkrimin: "IMPRESSO MERSA MILANO, ITALIA". Firma "Mersa" kishte pushtuar edhe rrugët e Italisë. Binte veçanërisht në sy humanizmi i tij dhe përpjekjet për punësimin dhe ndihmën ndaj bashkëfshatarëve të tij. Kush punoi me Selmanin u bë një mjeshtër i vërtetë i punës me dru dhe i skalitjes së gurëve.

Ai doli në pension në moshën 60 vjeçare dhe së bashku me bashkëshorten Anifën rritën dhe edukuan më së miri tetë fëmijët e tyre Aishen, e cila ka punuar në Shtëpinë Qendrore të Oficerëve, Pashaudinin, që ka patur post drejtues në NSHRAK-un e Tiranës, Eminenë, që ka punuar në Uzinat ushtarake të Artilerisë, Qerimenë që ka punuar në Fabrikën e Porcelanit, Dudien që ka punuar në administratën e shkollave, Fatmirën që ka qenë një tipografe e zonja, Shpresën, guzhinjere e talentuar dhe Skënderin, shofer eksperti.

I itillë ishte mjeshtri dhe sipërmarrësi Selman Mersa nga Stebleva. Ai vdiq para kohe në vitin 1970, në moshën 66 vjeçare duke lënë një trashëgimi të madhe dhe duke pasuruar traditën shqiptare dhe atë të Steblevës në fushën e ndërtimit dhe të montimeve.

Osman Uliu

Origjina e Ataturkut, Stebleva e Dibrës



Ramazan Hoxha, studiues

MUSTAFA QEMAL ATATURKU DHE RRËNJËT E TIJ NGA STEBLEVA E DIBRËS

Pleqtë Vahit Ereqi nga Gjinaveci dhe Destan Bala nga Stebleva e Dibrës tregojnë se Mustafa Qemal Ataturku është biri i një nëne nga Sebishti ndërsa i jati i tij ka qenë nga Stebleva. Ata janë larguar në emigrim në Selanik ku më 11 mars 1881 ka lindur Mustafa Qemali. Tokat e tyre në Steblevë janë edhe sot, tokat e Conkajve poshtë malit të Osojit. Nga Conkajt ka rrjedhur fisi Kuburi, një fis që e ka marrë këtë emër pasi ishin zanatçinj të prodhim-it të armëve, çifteve dhe kobu-ve. Ky zanatçi me emrin Ramadan Conkaj thirrej Ramadan Kuburi dhe kështu vazhdoi mbiemri Kuburi. Kuburajt emigruan kryesisht në Selanik dhe Stamboll.

Vetëm për të ndërtuar çezmën në vendin e quajtur Terzicë, Mustafai kur u bë gjeneral dhe udhëheqës i Turqisë moderne ka paguar dy qese me flori.

Në vitin 1861 janë larguar nga Stebleva e Dibrës 14 familje për në Selanik, ndër to edhe familja e Pirush Konkos dhe Vesel Kuçuku. Familja Kuçuku pas 40 vjetësh kthehet në Shqipëri, por jo në Steblevë, por në Tiranë, ku banojnë edhe sot. Ndërsa familja e Pirush Konkos largohet nga Selaniku dhe vendoset në Stamboll rreth

vitit 1900.

GJYQI PËR PRONËSINË E TRUALLIT TË CONKAJVE (KUBURAJVE)

Në vitin 1936 është zhvilluar në Steblevë gjyqi për pronësinë e truallit të Conkajve. Gjyqi me gjyqtarë të ardhur nga Tirana dëgjoi deponimet e tre pleqve të fshatit Vesel Kuçuku, Sadik Avda dhe Jonuz Disha. Vesel Kuçuku që banohte në atë kohë (1936) në Tiranë, pas kthimit nga Selaniku vërtetoi se trualli ku është sot shtëpia e Faslli Kuburit (nip tek dera e Conkajve) është trualli i Pirush Konkos, gjyshit të Qemal Ataturkut. Gjyqi u zhvillua ndërmjet Jashar Lamës dhe Faslli Kuburit dhe u fitua nga ky i fundit, pasi ky ishte nip tek Conkajt dhe i vetmi i afërt që kishte mbetur.

TAKIMET ME QEMAL ATATURKUN DHE POHIMI I TIJ MBI ORIGJINËN E TIJ

Rrënjët e tij shqiptare prej fshatit Steblevë të Dibrës i tregojnë edhe ngjarja që po ju tregojmë:

Një steblevas nga Bandajti në Stamboll në një kafe vret prefektin e qytetit sepse ai shan Shqipërinë. E dënojnë me vdekje. Një grup steblevas shkojnë te Qemal Ataturku dhe i kërkojnë që t'i falë jetën. Mustafa Qemali ka thënë: "Për ta vrrarë nuk e vrasim, por jam i detyruar ta internoj".

Takimi i dytë:

Në vitin 1926 Dail Ereqi nga Gjinoveci dhe Xhel Agushi nga Stebleva, kurbetli dhe specialistë ndërtimi në Stamboll janë takuar rastësisht me Qemal Ataturkun. Ndërsa po punonin për restaurimin e një xhamie ata kanë marrë përgëzimet e kryetarit të shtetit turk Qemal Ataturku. -Punë të mbarë, o ustallarë, i përshëndet Qemali.

-Mbarësi e mirësi paç, o

njeri, ju përgjigjen me respekt, por pa e ditur se kush ishte por vetëm duke e marrë me mend sepse ishte i shoqëruar nga njerëz që e ruanin.

-Ju lumshin duart, qenkeni mjeshtër të zot e duar artë. E paskeni bërë më të mirë se ç'ka qenë para shkatrrimit nga lufta. Nga ju kemi?

-Nga Shqipëria, i përgjigjemi.

-Po nga çfarë krahine? pyeti prapë ai.

-Jemi nga Golloborda, njëri nga Gjinoveci dhe tjetri nga Stebleva, ju përgjigjëm, pasi u bindëm se ai e njihte mirë Shqipërinë dhe pasi kishim marrë komplimentat për punën e mirë.

Ataturku nxorri nga xhepi një bllok dhe na tha: "Edhe unë andej jam, nga Stebleva. Gjyshi im më ka lënë amanet arën e Conkajve, të cilën e shprehu në maqedonisht "Conkojca Ograda".

-A keni ndonjë nevojë? pyeti Mustafa Qemali

Ishte rasti për t'u shprehur, Kishte ardhur e mira tek dera.

-Mbetëm kurbetçinj, gjithë jetën pa familje, i thamë.

Kaq u desh dhe na u bë menjëherë nështetësia turke dhe na u dha banesë bile edhe më të mirë se vetë turqit.

EKSPOZITA NË TIRANË KUSHTUAR ATATURKUT

Në vitin 1984. në kuadrin e 60 vjetorit të formimit të shtetit të ri turk, u hap në Pallatin e Kulturës në Tiranë, një ekspozitë kushtuar Turqisë moderne dhe arkitektit të këtij shteti modern Ataturkut. Edhe në pemën e gjenezës së familjes së Qemal Ataturkut vërtetohet origjina e tij shqiptare dhe vendlindja e tij në Selanik. Ciceroni i ekspozitës shtetas turk me origjinë kosovare pohoi nën zë se Ataturku është me origjinë nga Dibra e Shqipërisë.



Ismet Toto, autor i librit "Ataturk"

FËMIJËRIA DHE SHKOLLIMI

Babai i Mustafa Qemal Ataturkut ka qenë Ali Riza Beu, një nëpunës i thjeshtë i Perandorisë Osmane me shërbim në Selanik. Origjina e tij si arnaut ka qenë deklaruar herët, por Shqipëria atëherë ka qenë pjesë e Perandorisë Turke. Beu është titull dhe jo mbiemër. Nëna e Mustafait ka qenë Zybejde Hanëmi. Babai i saj ka qenë nga Sebishti i Dibrës, ndërsa nëna ka qenë nga Jugu i Shqipërisë.

Zonja Zybede, një hanëm i vërtetë si nga prejardhja ashtu edhe vrytytet e edukoi Mustafain me shkollë dhe me vrytytet e saj. Ndërsa Zybejdja

ngulte këmbë tek ritet myslimane, Aliu ngulte këmbë në shkollimin evropian të të birit. Kështu Mustafai u regjistrua në shkollën "Shemsi Efendiu", të Selanikut, e cila drejtohej me metoda dhe parime evropiane.

Kur ishte vetëm 9 vjeç Mustafai mbeti jetim për baba. Kështu Zybejdja mbeti në hall në mes të udhëve të Selanikut me dy fëmijë jetim me djalin Mustafanë dhe vajzën Makbulen. Nga halli u vendos tek e motra në një çiflig jashtë Selanikut, në një vend që quhej Lazasan. Në këtë vend dhe në këtë çiflig Mustafa ndonëse pa dëshirë u muar me bujqësi dhe bagëti. Kjo e bëntë të rrinte shpesh i vetmuar dhe të meditoonte shumë e të mendonte planet për të ardhmen.

(Vijon në faqen 7)

PROF. EQREM ÇABEJ: NËNA E ATATURKUT ËSHTË NGA SEBISHTI I DIBRËS



ALI HOXHA historian, gjuhëtar, ish student i Prof. Eqrem Çabejt

Duke marrë shkak nga shkrimi i z. Sakip Cami, me titull "Mustafa Qemal Ataturku, shqiptari nga Stebleva që u bë reformatori dhe krijuesi i Turqisë moderne", e gjykoj që për të përforcuar origjinën shqiptare të Mustafa Qemal Ataturkut të shtoj edhe unë një argument tjetër, duke bërë publike një dëshmi të Prof. Eqrem Çabejt për këtë çështje, para 30 vjetësh, në qytetin e Peshkopisë, pikërisht më 19 maj 1978.

Më 19 maj 1978, Prof. Mahir Domi dhe Prof. Eqrem Çabej erdhën në Peshkopi me rastin e një sesioni shkencor "Për probleme të gjuhësisë dhe të dialektologjisë", që u bë më datë 20 maj 1978, i organizuar nga Shoqata e gjuhëtarëve të rrethit të

Dibrës, në bashkëpunim me Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në pritje të tyre kishte dalë z. Myfit Trepça, me cilësinë e kryetarit të shoqatës së gjuhëtarëve të rrethit të Dibrës; Ali Hoxha, me cilësinë e nënkryetarit të shoqatës dhe z. Hilmi Sadikaj, anëtar i shoqatës. Pas stabilizimit në hotel dhe pas pushimit të çastit, me kërkesën e prof. Eqrem Çabejt, bëmë një shëtitje në bulevardin kryesor të qytetit, për t'u njohur me qytetin, sepse, siç na tha vetë profesori, ajo ishte vizita e tij e parë në Dibrë të Poshtme.

Sesioni shkencor u zhvillua në kuadrin e manifestimeve të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1978, prandaj edhe biseda e rastit gjatë shëtitjes, u përqendrua kryesisht rreth asaj teme.

"Në seancën e parë të sesionit shkencor u mbajtën këto kumtesa:

- Nga prof. Mahir Domi: "Problemet e dialektologjisë dhe të onomastikës në fazën e sotme"; nga prof. Eqrem Çabej: "Dialektologjia historike dhe toponimia"; nga mësuesi Ali Hoxha; "Një vështrim i shkurtër gjy-

hësor mbi toponimet e fshatit Çidhën" dhe nga Qani Përtafi: "E folmja e fshatrave të kooperativës së bashkuar Qendër".

Edhe në seancën e dytë u mbajtën kumtesat nga Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor Jorgji Gjinari: "Atlasi dialektologjik i shqipës - hap i rëndësishëm në studimin e gjuhës me metodën e gjeografisë gjuhësore. U lexua kumtesa e Bashkëpunëtorit Shkencor Minella Totoni: "Çështje të sintaksës dialektologjike" dhe u mbyll me kumtesën: "Përpyetje për të shpjeguar disa toponime të krahinës së Zerqanit", nga mësuesi Fiqiri Novaku ("Ushitima e Maleve", 24 maj 1978, f. 1).

Ndër të tjera, ra fjala edhe për aktivitetin e Mustafa Qemal Ataturkut. Kur më erdhi rasti, unë bëra këtë ndërhyrje:

"Këtu në Dibrë kemi shumë pleq që kanë qenë bashkëluftëtarë me Mustafa Qemalin dhe që na kanë folur për origjinën e tij shqiptare. Disa prej tyre janë ende gjallë, nga të cilët unë i njoh personalisht, si: Ramadan Cani nga Dardha e Dibrës, i cili ka qenë adjutant i Ataturkut dhe Maliq Gjoni nga fshati Mustafaj. Me këtë të fundit kam folur personalisht për

këtë çështje dhe më ka thënë se ai vetë ka folur personalisht me Mustafa Qemalin disa herë kur ai shërbente në ushtrinë e Perandorisë Osmane dhe më ka pohuar origjinën shqiptare të Mustafa Qemalit. A thua të jenë të vërteta këto pohime apo mos kemi të bëjmë me dëshirën tonë si shqiptar?"

Në ato moment ashtu siç ishim duke shëtitur në bulevard, pikërisht në vendin ndërmjet turizmit dhe kinemasë, e mori fjalën prof. Eqrem Çabej, i cili tha shprehimisht kështu: (citoj në ligjëratë të drejtë):

"Unë njihem me një dhëndër të Zija Dibrës. (Zija Dibra ka qenë ish-bashkëluftëtar, shok dhe mik i Mustafa Qemalit, dhe ish-deputet i Dibrës në Parlamentin e A. Zogut - A.H.).

Ai më ka thënë: "Zijai më ka treguar se në një banket që ishte shtruar pas fitores së forcave ushtarake turke në një betejë kundër forcave greke ku ai kishte qenë i pranishëm se Mustafa Qemali kishte ngritur një doli për nder të një gjenerali shqiptar nga Kosova, që ishte dalluar në atë betejë, duke e përshëndetur shprehimisht kështu: "Ju kosovarët jeni trima, por ne dibranët jemi më të zg-

juar".

I entuziazmuar nga një përgjigje e tillë dhe e papritur, unë nuk e përmbajtja dot vetveten, por ndërhyra në këtë pyetje:

"Profesor! Ne mendonim me rezerva për origjinën shqiptare të Ataturkut, kurse ju na e bëtë dibran! Nga se vërtetohet kjo?"

Profesor Eqrem Çabej u përgjigj:

"Nëna e Mustafa Qemalit është nga katundi Sebisht i Dibrës..."

Të gjithë të pranishmit e tjerë në momentin e këtij deklarimi historik të profesor Çabejt, tashmë janë të vdekur përveç meje. Të mos harrojmë se Çabej ishte një njohës i mirë i Dibrës sepse ishte dhëndërr Dibre, gruaja e tij ishte nga Dibra e Madhe, nga fisi Kurteshi.

Duke gjykuar se një pohim i tillë, si i lartpërmenduri dhe nga një personalitet i lartë shkencor si prof. Eqrem Çabej, është një dëshmi me vlerë për historinë e kombit tonë, mendova ta bëj publike në shtyp, sepse unë jam i vetmi dëshmitar okular i mbetur i gjallë nga të pranishmit e atij momenti. Kur ka vdekur Ataturku Çabej ka qenë 30 vjeç.

SI MBIJETUAM NË ATO VITE TË VËSHTIRA LUFTE

(Kujtime nga Ferit Pirushi)



Unë, Ferit Bexhet Pirushi kam lindur në Steblevë në vitin 1935. Shtëpia jonë ka qenë ku ka qenë shtëpia e Rexhep Gjerranit.

Në vitin 1939 u dogjën katër shtëpi dhe u larguam tek gjyshi Sulejman Dula (babai i nënës). Babai im Bexhet Pirushi ka lindur në Steblevë dhe është i datlindjes 1900.

Sipas tregimit të babës, ne e kemi prejardhjen nga fisi Dishha. Fisi Dishha është i ardhur nga Ulqini rreth 250 vjet më parë. Emigrimi i tyre ka qenë për shkak të përndjekjeve serbo-malazeze. Brodhën në shumë vende dhe u vendosën në Steblevë sepse në vende të tjera toka ka qenë e okupuar nga çifligarë e bejlerë vendas. U vendosën në Steblevë mbasi u lejuan dhe u mirëpritën nga i pari i Steblevës në atë kohë, i cili u caktoi një djerrinë ose kullotë që quhej: "Çajre e Turkut". Në këtë vend për herë të parë Dishajt shkarkuan mushkat dhe u vendosën në Steblevë. Kanë qenë tre vëllezër Dishha, Projku dhe Uliu, që më vonë do të formonin tre fise të tjera. Këto mi ka treguar edhe Jakup Projku tre muaj para se të vdiste. Jakupi më tregoi edhe fshatin e prejardhjes së tij prej Ulqini, por unë nuk e shkruajta dhe nuk e mbajta mend.

I pari ynë Halil Dishha ka patur dy djem dhe një vajzë. Djali i madh i Halilit, Pirushi ka patur tre djem dhe pesë vajza. Nga Pirushi lindi fisi tjetër Pirushi.

Ali Dishha ka patur për grua motrën e Midil Gjerranit, Ibrimen. Sefedini ka patur për grua Zylfien, motrën e Vaid Kormakut. Bexheti ka patur për grua Eminen, të bijën e Sulejman Dulës. Ibrahim Dishha e ka patur të shoqen nga fisi Gruja, baxhanak me Destan Dishën, të jatin e Jakup Dishës. Ka patur një vajzë të martuar me Destan Kormakun. Bajram Dishha martuar me motrën e Zylfyt Kitës. Vajzat e Pirush Dishës janë martuar respektivisht me Egerem Agushin, vëllai i Ismail Agushit emigruar gjatë zisë së bukës në Korçë. Tjetra është martuar me Demir Tamizin. Vajza e tretë është martuar me Arif Kitën, të birin e Iljazit. Vajza e katërt është martuar me të jatin e Hysen Radës. Vajza tjetër është martuar me Bejto Shutinën në Gjinavec.

Pirush Dishha në vitin 1906 ka qenë në Qabe dhe atje ka vdekur. Që nga ajo kohë fëmijët e tij kanë ndryshuar mbiemrin nga Dishha në Pirushi në kujtim dhe respekt të tij.

Xhemal Dishha ka patur një djalë që quhej Dish Dishha. Dishha ka lënë dy fëmijë jetimë që i ka rritur Pirushi dhe kushuriri i tij Aliu me vëllezërit.

Babai im Bexheti na ka lanë amanet që me Dishajt të mos marrim dhe të japim se jemi shumë gjak i afët.

Pirush dhe Xhemal Dishha kanë shkuar në Shkup me punu-

ar rreth vitit 1850. Me vehte kanë patur edhe djem të tyre. Atje kanë kryer shkollat turke sepse shkolla shqipe në atë kohë nuk ka patur dhe kanë marrë titullin "Myfti". Pas vdekjes së Xhemalit mbi varrin e tij është ndërtuar një teqe me miratim të Kryegjyshitës.

Pirushi ka qenë sipërmarrës ndërtimi shtëpish që nga themelet e deri në dorzim çel-sash. Më vonë për shkak të dëshirës së tij për perfeksion pune dhe nivelit të dobët të ustallarëve vendas që kish në brigadën e tij të punës, hodhi veglat e punës në lumin e Vardarit dhe nuk u muar më me ndërtim.

Xhemali ka qenë tregëtar ambulant materialesh kinkalerie pranë portës së një regjimenti turk për tu shërbyer sa më mirë ushtarëve. Këtë punë e vazhdoi edhe Pirushi i cili me lejen e gjeneralit, komandantit të regjimentit e bazoi kjoskën e tij brenda regjimentit. Më vonë bleu një kjoskë më të madhe, në një vend më të mirë, vajti në Stamboll dhe atje u muar me tregëti.

U detyrua të kthehej në atdhe pas luftave të asaj periudhe. Në hejbet e mushkave, me ndihmën e kaçakëve të paguar për garanci, arriti që në mes të elbit të maskonte paratë (florinjë) e fituara dhe me ato para, rifilloi tregëtinë në Kavajë në vitin 1895.

Për verim në Steblevë, për dimërim në Kavajë

Në Kavajë blenë 12 shtëpi. Në verë veronin në Steblevë, sepse në Kavajë nuk pëlqenin klimën dhe ujin me kripë. Pas Kavajës hapën hane në Gosë, Elbasan dhe Durrës ku vijuan tregëtinë e tyre nëpërmjet rrugës "Egnatia".

Familja ishte e madhe rreth 60 frymë me nipër e mbesa. Fisi Dishha në këtë kohë ka bërë synet 25 djem përnjëherë, nga më i vogli deri tek Baftjari që ishte 18 vjeç. Dasëm e madhe dhe ushqim i madh për këdo që hynte e dilte në atë shtëpi të madhe. Ali Dishha kishte fituar titullin Aga. Ali Agai ishte bërë i njohur në atë kohë në Kavajë.

Një ditë Ali Agai shkon në pazar dhe sheh se beu i Luzit kishte nxjerrë në treg kopenë me 500 kokë dele dhe po hahej në pazar me një plak nga veriu. Ndërhyn Ali Agai: "Sa të bën e gjithë kopeja or zotni?"

-Kush je ti more, që bleke të gjithë kopenë time? E pyet beu i Luzit.

Aliu nxjer kollanin dhe numëron napolonat. Delet i çon po në çifligun e beut, por me qira. Furnizon gjithë dyqanet e zonës dhe të qytetit me qumësht dhe gjithë çifligun e kthen në park zoologjik me kuaj të egër e të butë, lopë, qe, buaj etj. Kuajt i zbutte dhe i përdorte për transport mallrash dhe për kalërim me shalë.

Llogarinë e mbante e shoqja e Ibrahimit, çdo mbramje, duke seleksionuar lirat turke, që nga një çerekshja deri tek pesëshja. Veçmas lirat e arit e veças lirat e argjendit. E shoqja e Bajramit merrej me edukimin e fëmijëve si një edukatore e mirë.

Bariu studioje në Shkollën Normale të Elbasanit. E përcillnin të hënën me kalë për në Elbasan dhe e merrnin të shtunën për pushim në shtëpi në Kavajë.

Mbas sezonit të qumështit, delet i çonim me bari për verim në Steblevë. Livadhin e Baushicë Bella Rekës e kemi blerë nga fisi Baushi dhe atë emër ka edhe në kadastrën e sotme. Barinjët i paguante me rrogë. Edhe fëmijët shkonin në stane si për ruajtjen e bagëtive por edhe për verim e klimë të mirë. Plehronim arat tona dhe të Bajram Kitës e të Avdajve. Një rradhë na zuri dëbora e parë që herët dhe mezi zbritëm në Borovë, pasi dëbora i kishte kaluar 50 cm. Qingjat e rinj mezi i shpëtuam, duke lypur dhe duke blerë bar, dushk dhe tagji. Disa qingja ngordhën. Atë kohë vdiq Aliu. Vdiq nga damllaja, nga e keqja e madhe.

Në vitin 1905, në moshën 95 vjeçare Pirush Dishha dëshiron të shkojë në Qabe, por asnjë shok nga Stebleva nuk doli vullnetar për të shkuar bashkë me të. Doli vetëm Imer Basha, djali i Ismail Bashës nga Gjinavec.



Ka ftuar për drekë shokë nga të gjithë fshatrat e lokalitetit të Klenjës. Çdo fshat vinte me ahengun e vet. Janë therrur rreth 80 krerë viça, dele e qingja. Pas drekës u nisën drejt Shkupit, nën shoqërinë e karvanit të gjatë të njerëzve. Përcjellja u bë në vendin ku sot është piramida 30, në të dy anët e rrugës së Çajres së Rade Pirushit. Ma bani hallall, ka kërkuar Pirushi.

Në Shkup i ka dhanë berberit që e ka qethur një lirë ari, se Pirushi thoshte se ai që të rregullon kokën e ka hallall hakun dhe bakshishin. Pirushin e ka shoqëruar Imer Basha, të cilin i ka dorzuar 400 lira turke ari. Me këto pare të çosh ujin në kodër dhe ato që teprojnë të kujdesesh për fëmijët se s'dihet a kthehem a po jo, i ka thanë Pirushi. Kur janë nda tek ahu, Pirushi përkulet, merr një dorë dhe, e mbështjell në një shami, e fut në xhep dhe i thotë: "Do shkoj dhe s'dihet a do të kthehem më. Pas faljes në Qabe, Pirushi bleu dhurata për vajzat, nusët e djemve etj. Ruajt një fije floku të Pejgamerit dhe bizhuteri të veçanta. Bleu edhe një vezë struci që e la amanet që të varet tek xhamia e Steblevës. Ai vdiq në Arabi, në krah të Ymerit dhe varrin e ka atje.

Në ditët e vështira të pushtimit bullgar

Tek Gatra e Steblevës tako-

hemi me Sotir C farkun në shtëpinë e tij. Sotiri me plakën e tij na fton me dashuri. Heq kapelën e bardhë dhe duke ju lutur Zotit uron: "Mos u harroftë emri Pirushi!" Na kanë ndihmuar në ditët e vështira.

Vangjel C farku emërohet kryeplak i Steblevës në kohën kur bullgarët patën pushtuar Steblevën në vitin 1916. Pushtuesit kërkonin të dhjetat, taksa nga banorët dhe Vangjeli ishte shumë i zellshëm për të marrë të dhjetat e prodhimit e tjera të banorëve. Vangjeli kërkonte bukë e ushqim nga banorët nën preteksin se kishte harxhime si kryeplak, në një kohë kur populli kalonte krizë.

Bullgarët dhe serbët bënë edhe prerje pemësh e veprime të tjera terrori duke i detyruar njerzit të futnin drutë nëpër shtëpija. Kufiri Orvenik-Pishtevic-Presllok-Raduç ruhej nga rojet serbe. Xhelepi që pat grumbulluar Vangjeli u bllokua nga dimri. Postkomandant në Klenjë ka qenë Nikoll Popa. Hasan Nura, babai i Limanit në atë kohë ka qenë korier katundi. Tek mullinjt

vitin tjetër. Fisi Gruja shquhej për prodhim. Një shkrimtar tiranas që quhej Skënder Jaska ka qenë shtëpi me shtëpi dhe ka shkruar për Steblevën. Nga Steblevasit për historinë tonë ka punuar Vahid Kormaku, Islam Hoxha dhe i biri Ramazan Hoxha. Por duhet të punojmë më shumë sepse ka shumë për të shkruar e zbuluar.

Ishte vjeshtë e vitit 1910

Barinjve të lagjes Dishaj, Projka dhe Ulie u afrohen disa kaçakë të armatosur me pushkë për ti trembur dhe për tu rrembyer bagëtinë. Qëllojnë drejt tyre, në fillim për ti trembur që të lënë bagëtinë. Bexheti shkon tek kisha orodokse, ngjitet tek roja dhe i thotë Spase Rajkut që ti bjerë çangës se kanë ardhur kaçakët për të marrë bagëtinë.

Nga lagja Dishha zbresin shumë pushkatarë dhe shkojnë në malin e Ongjerit ku presin të kalojnë bagëtitë e grabitura.

Tregimet për vitet 1912-1916 i kam marrë direkt nga Martin Rajka, dëshmitar okular, i cili vdiq 95 vjeç.

Kuajt e nemces

(Dëshmi e pushtimit të nemces (austro-hungarezve)

Para fillimit të Luftës së parë Botërore aty rreth vitit 1914, në Steblevë kanë qenë edhe pushtuesit austro-hungarezë. Një ushtri e madhe plus edhe një zi buke e paparë e shoqëruar me sëmudnje kolere. Tek Posta e vjetër kanë vdekur nga të ftohtit dhe uria dy ushtarë austro-hungarezë. I kemi varrosur larg fshatit, në Rasadisht ku kanë edhe sot varret. Kuajt i kanë pasë mbajtë tek ara e Gaxhajve pranë shtëpive të Dulajve. Aty kanë ngordhur shumë kuaj që i kanë tërhequr fshatarët dhe i kanë hedhur në përrua. Këto i tregon te Hajrulla Dula që i ka jetuar vetë këto ngjarje dhe ka qenë korier në atë kohë.

Afër shtëpisë së Sadik Kitës ka qenë një kanal i madh për vaditje. Edhe sot po të gërmosh gjen kocka dhe patkonjtë mëdhenj kuajsh. Deri vonë ka egzistuar shprehja: "si kuajt e Austrisë" sepse kanë qenë kuaj shumë të mëdhenj.

Në kohën kur ngrihej flamuri në Vlorë...

Serbia dhe Krajl Pjetri në nëntor 1912 duke ndier aktin e pavarësisë që po përfaqësoj nëpërmjet udhërrëfyesit të saj kërkon nga Stebleva rrugë për në Durrës. Kur kryepleqësia e Steblevës nuk i dha leje kalimi, serbët u tërbuan dhe vendosën të sulmojnë. Në ato momente Bajram Shapka bën thirrje për ti pritë tek Kodra e Baushit. Pritja me pushkë i tërboi serbët që pasi futën në fshat djegin disa shtëpi. Kjo ishte një djegje e pjesëshme. Më pas ata marshojnë drejt malit Letëm. Por burrat e Steblevës zënë pritë dhe detyrojnë të kthehen mbrapsh forcat serbe të cilat lanë të vrarë 100 ushtarë.

Krajl Pjetri i tërbuar ka thanë: "Çfarë populli paska qenë ky populli i Steblevës. Ma sillni një kokë njeriu nga ky vend."

Por serbët nuk kanë patur mundësi tjetër veçse të tërhiqen me turp drejt Strugës.

(Vijon nga faqja 5)

Por shqiptarja sedërmahe Zybejde Hanëmi nuk deshte kurrësesi që i biri të mbetej bujk dhe bari. Të paktën të bëhej një nëpunës i vogël si i jati. Prandaj e dërgoi Mustafanë në Selanik Qytet tek një kushurirë e saj që të ndiqte mësimet. Puna 2 vjeçare me bagëti dhe klima e mirë në fshat e kishin fuqizuar shëndetin dhe trupin e Mustafait. Ishte bërë më i mendueshëm, i pashoqërueshëm dhe pak i ashpër, ashpërsi që e shoqëroi deri në fund të jetës. Me ndërhyrjen e kumatit të Zybejdes meqenëse Mustafai grindej me shokët e shkollës dhe ishte tepër i ashpër, pas një viti e regjistruan në shkollën paraushtarake të nxënësve në Selanik. Këto shkolla në të gjithë vendin drejtoheshin dhe mbaheshin nën kujdesin e vetë Sulltanit.

Mustafai hyri në shkollën ushtarake të Selanikut me dëshirë dhe qejf të madh sepse i pëlqente uniforma e bukur ushtarake. Kjo e bënte kryelartë si malësor që ishte. Edhe mësuësia e matematikës e qanin Mustafa. Por në matematikë Mustafai ishte i shkëlqyer ose siç i thonë në turqisht Kemal, ndaj mësuësia e quante Mustafain Mustafa Kemal, Mustafai i shkëlqyer. Meqenëse ishte shumë fodull dhe kishte dëshirë të komandonte të tjerët, të dukej mësuësia dhe drejtuesit e shkollës e vinin atë kujdestar. Kështu filloi ndoshta dëshira e tij për të sunduar, për të drejtuar të tjerët. Mbasi mbaroi studimet në Selanik u dërgua në Shkollën e mesme ushtarake të Manastirit dhe më pas në Shkollën Ushtarake "Harbije" të Stambollit.

Veli Stafa
(Nipi i Qemal Stafës)

SHOQËRIA E BABAIT TË QEMAL STAFËS ME MUSTAFA QEMALIN (ATATURKUN)

I jati i Qemal Stafës, Kolonel Hasan Stafa dhe Mustafa Qemali kanë mbaruar shkollat e larta ushtarake në Manastir dhe Stamboll. Në shenjë të miqësisë së tyre i jati i Qemal Stafës ja vuri emrin djalit të tij Qemal sikurse shoku i tij Mustafa Qemali. Qemal në turqisht do të thotë i shkëlqyer dhe babai i Qemalit dëshironte që djali i ardhshëm i tij të bëhej i shkëlqyer, Qemal. Hasan Stafa dhe Mustafa Qemali studiuane Akademien Perandorake Ushtarake të Manastirit një shkollë ushtarake, e njohur si Lice ushtarak në Perandorinë Osmane.

Qemal Ataturku ka qene me origjinë nga Stebleva, fshat kufitar me Zabzunin, gjë e cila ka qenë edhe një nga arsytet e lidhjes miqësore të dy të rinjve. Ndërsa Shkollën e Lartë të Oficerëve të Shtatmadhorisë e kanë mbaruar në Stamboll (Akademia Ushtarake "Harbije") me 1902, duke dalë prej saj me gradën Toger në vitet e para të shek.20. Pas formimit të Shtetit Shqiptar nga Ismail Qemali dhe bashkëpunëtorët e tij, Kapiteni Hasan Stafa megjithë lutjet e Qemal Ataturkut, shokut të tij të Akademisë dhe idealeve në luftën kundër absolutizmit të sultan Abdyl Hamidit për të punuar bashkë në ushtrinë turke, nuk pranon dhe kthehet në Shqipëri.

Me rastin e 541 vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut

Nga luftimet e Skënderbeut në zonën e Steblevës *

NDËRTIMI I FORTESËS SË MODRIÇIT

Skënderbeu për ti bërë ballë rrezikut që i shkaktoi humbja e Sfetigradit, ndërtoi me të shpejtë fortesën e Modriçit, ballë për ballë me Sfetigradin (Koxhaxhikun e sotëm). Kjo fortesë e mbyllte grykën e Drinit dhe kontrollonte lëvizjet e ushtrisë turke dhe i lajmëronte kështjellat e tjera me anë të topit. Kështu brenda një kohe të shkurtër lajmërohej Skënderbeu, kudo që të ishte për të ardhur në kohën e duhur. Kjo taktikë e Skënderbeut, lajmërimi me top, (që zëvendëson telefonin e sotëm), u ka mbetur trashëgim malësorëve të Dibrës, të cilët në kohë rreziku e lajmërojnë shoqi shoqin duke shti me pushkë katund për katund. Ky alarm jep kushtrim për tu mbledhur burinija e armatosur kundër rrezikut të përbashkët. Forcës së bashkuar të malësorëve nuk ka armik që ti bëjë ballë.

LUFTA E MODRIÇIT

Nga Kalaja e Modriçit gjëmuan topat që lajmëronin se dy ushtri të mëdha turke po i afroreshin Shqipërisë. Skënderbeu la në mes përplasjet me kapidanët shqiptarë dhe vrapoi në drejtim të Dibrës.

Komandanti turk Talip Pasha e nisi përpara Hamza Pashën me 10000 ushtarë dhe ai vetë po vinte mbrapa me 15000

të tjerë.

Më 12 korrik 1452 Skënderbeu e goditi Hamza Pashën afër Modriçit dhe e dërmoi duke e zanë rob bashkë me shtabin e tij. Në krye të ushtrisë shqiptare ishin Moisiu i Dibrës dhe Hamza Kastrioti që përbënin pararojën e ushtrisë. Forcat e tjera i mbajti të përqëndruara.


Pastaj ushtria e Skënderbeut i turrent Talip Pashës të cilin e ndesh në Maçad. (mendohet të jetë Borova e sotme, ku asht edhe kalaja e Maçadit).

Para se të ndizet beteja, shqiptarët ua treguan turqve Hamza Pashën me oficerët e tij të zanë rob dhe flamurët turq që kishin fitue në Modriç. Turqit megjithëse të dëshpëruem nga kjo pamje vazhduan luftën. Ishte beteje e balancuar. Moisiu i Dibrës që ishte në ballë e njuh Talip Pashën nga uniforma, çan udhën midis ushtarëve turq dhe e godet me shpatë atë duke e lënë të vdekur. Ushtria turke e mbetur pa komandant u shkatrrue dhe mori arratinë.

LUFTA E MAÇADIT

Kalaja e Maçadit ndodhet në Borovë të Dibrës. Këtu asht zhvilluar edhe beteja e Maçadit në qershor të vitit 1465 kundër forcave turke të komanduara nga Ballaban Pasha.

Ballabani sipas zakonit të atëhershëm i dërgoi dhurata të pasura Skënderbeut. Edhe Skënderbeu i dërgoi dhurata në



këmbim të tyre, por me një domethënie. Ai i dërgoi një kërribë, një shat dhe një plug që ti jepte me kuptuar që do të bëje ma mirë të kishe ndenjtur bujk dhe blegtor në Mat se të ishe ba gjeneral e pasha i Turqisë e të luftoje kundër vendit tand, Shqipërisë.

Ballabani sigurisht u tërbua nga këto dhurata ironizuese dhe vendosi ta sulmonte befasisht

ushtrinë e Skënderbeut që ndodhej në Maçad afër Dibrës së Madhe.

Skënderbeu ja kuptoi planin e luftimit dhe e futi midis dy zjarreve, dhe e dërmon ushtrinë e tij. Ballabani mezi arriti të largohet vetë megjithë pjesën e mbetur.

*Sipas Historisë së Dibrës të Haki Sharofit

Po të mos ishte Drini...

(Rreth novelës së Naim Plakut me subjekt nga koha e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu)

Tani lexuesi shqiptar kudo që ndodhet brenda dhe jashtë vendit dhe veçanërisht lexuesi dibran ka në duar një perlë të urtësisë dibrane, librin e Naim Plakut "Po të mos ishte Drini". Është edhe merita e botimeve "mb" dhe e botuesit dibran tashmë me përvojë Bujar Karoshi, që bëri të mundur që të kemi këtë libër me vlera të mëdha artistike, historike, kulturore, folklorike dhe edukative për brezat.

Autori i qindra poezive dhe këngëve, i dy librave me poema dhe vjersha Naim Plaku, vjen këtë herë me një sukses të ri, me lëvrimin e tregimit popullor dibran të përpunuar, që është padyshim një zhanër i bukur dhe shumë i kërkuar për të gjithë brezat.

Një pjesë të këtyre tregimeve, rrëfimeve, meseleve dhe historive i kisha lexuar edhe në gazetën "Rruga e Arbërit" dhe më kishin pëlqyer shumë.

Sigurisht Naimi nuk është i pari në këtë fushë, por ndoshta është më i talentuari, më punëtori dhe më i duruari. Kjo është një punë kolosale në gjurmët e Haki Stërmillit, Hazis Ndreut, Hilmi Kolgjegjës, Xhafer Martinit, Bajram Hysenit, Xhelal Ndreut e të shumë shkrimtarëve e studiuesve dibranë që e kanë ngritur urtësinë dibrane në ato nivele që është me të vërtetë ajo dhe që e meriton të jetë.

Ky është një libër që nuk duhet ti mungojë asnjë shtëpie dibrane, asnjë emigrantit dhe pse jo edhe asnjë shqiptari që

kërkon të dijë nga vjen dhe ku don të shkojë.

Libri hapet me novelën historiko-artistike "Po të mos ishte Drini..." kushtuar kohës së Skënderbeut. Autori u vjen në ndihmë edhe historianëve me ato hulumtime të kryera me ato toponime të nxjerra dhe me ato fakte të reja të padëguara deri më sot. Ai godet me veprën e tij edhe ato studiues të huaj dhe shqiptarë të shitur apo injorantë që godasin Skënderbeun dhe historinë e tij. Autori është pikërisht nga vendlindja e të jatatit të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, nga Çidhna, nga Sina dhe Gardhi i Poshtëm, që siç thotë Barleti ynë i famshëm në vitet 1500 ishin trojet e Kastriotëve dhe të të jatatit të Skënderbeut, Gjonit. Edhe sot në këtë fshat ndodhet një vend që quhet Gjergjish-te (Gjergj + ishte)

Personifikimi i Drinit edhe si lumë edhe si përrëndi, personifikimi i Setës edhe si lumë edhe si vajzë e bukur, si grua, është një arritje dhe gjetje artistike që do ta kishte zili çdo autor.

Dhe pikërisht me vdekjen e Gjergj Kastriotit në Lezhë dhe me njoftimin piskamë dhe jehonë të vdekjes së tij fillon novela "Po të mos ishte Drini..." me krismat e kalave të Çidhnës, Koxhaxhikut (Sfetigradit), Modriçit, (Steblevë), Meçadit, (Borovë), Kojavecit, Krajkës, Kubenit, Obokut etj për bashkim dhe për luftë të mëtejshme ndaj turqve dhe tingëllon si kushtrim edhe sot.

Dhe më tej dy personazhet e novelës Vidani dhe Seta, dy të rinj të dashuruar, janë kurbanët e kësaj lufte që do të vazhdojë për pesë shekuj.

Për tu bindur i dashur lexues me stilin, organizimin e shkrimit, subjektin e famshëm dhe burimin e pashtershëm popullor po japim vetëm një pasazh të kësaj novele që për stilin dhe përmbajtjen është unikale.

...Vidani hapi prapë sytë. Para tij qëndronte Seta, grua e ëndrrave të tij, Seta e butë, Seta e egër, Seta e bukur, nusja e tij e re, duke përkëdhelur mes gishtërinjve të bardhë unazën e çmuar, që e kish ruajtur në gjirin e saj tash sa mote. I mori dorën e majtë Vidanit, ja afroi mbi zemrën e saj që gufonte, ia vuri në gisht, lidhi dorën e saj me të Vidanit, siç e kishte të lidhur unaza, i puthi dorën e përgjakur ku shkëlqente porosia e Bip Hutës dhe amaneti i madh i Gjergjit. Të dy ranë në lëndinë si dy krahët e këputur të shqipes mbi mbi gjoks të njëri tjetrit. Kur Seta u zgjua, Vidani qëndronte si gjeth i verdhë në krahët e saj. Sa i lehtë ishte bërë ky burrë vigan! Seta i hapi aty një gropë me tehun e shpatës së Martinit. E mbuloi



me dheun e shkriftë të zallit dhe e lagu me lotët e syve të kaltër. Këtu, po, vërtet këtu është dhe varri i Vidanit. Po varri i Setës, vallë ku është?! Ka vdekur Seta apo është akoma gjallë e rron mes nesh?!

Libri përmban edhe 15 tregime popullore të tjera të zonës së Dibrës së Poshtme, të cilat shprehin humorin e hollë të popullit dhe godasin veset dhe gabimet e kohës.

Në fund, pa u zgatur do të thonim se Naim Plaku me këtë libër i ka bërë një shërbim shumë të mirë kulturës dhe traditës sonë kombëtare.

Sakip Cami

BOTIME TË REJA

Miq të ftuar në gazetën tonë

Mbi ndarjen territoriale-administrative në Shqipëri

(Për prezencën më të afërt të shtetit me qytetarët)

Dr. Besnik ALIAJ,
arkitekt, urbanist*

Vitet e fundit po piquet gjithnjë e më shumë opinioni se Shqipëria ka nevojë për një reformë të thellë administrative dhe territoriale në funksion të një qeverisje më të mirë të vendit.

Iniciativat në këtë drejtim nuk kanë munguar, por këto iniciativa janë bllokuar ndoshta edhe për shkak të mungesës së vullnetit ose nga fakti që ky debat shpesh politizohet.

Disa nga objektivat thelbësore të reformës administrative territoriale mund të synojnë:

-1) stimulimin e qeverisjes së mirë dhe të shtetit ligjor përmes krijesës së efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike dhe një planifikimi e administrimi më të mirë të territorit.

-2) realizimin në praktikë të decentralizimit (transferimit vertikal) dhe dekoncentrimit (transferimit horizontal) të pushtetit, kompetencave dhe financave drejt komuniteteve

-3) vendosjen e qytetarit të thjeshtë dhe të grupeve në nevojë në qendër të përfitimëve që do të burojnë nga reforma.

-4) stimulimin e transparencës, pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes maksimale në vendimmarrje.

Këto vitet e fundit është folur shumë për decentralizimin. Pas një fillimi të suksesshëm në hartimin e reformës, ajo ka ecur me shpejtësi tepër të ngadaltë, kryesisht si pasojë e mungesës së vullnetit politik, megjithë përpjekjet e bëra nga ministria e linjës.

Tashmë realizimi i plotë i kësaj reforme është një domosdoshmëri urgjente për të korrigjuar mënyrën e mbrapshtë se si ushtrohet kontrolli mbi burimet financiare dhe materiale të vendit, dhe mbi të gjitha, për të korrigjuar shpërndarjen e padrejtë dhe klienteliste të këtyre burimeve, bazuar në situatën dhe kushtet e krijuara sidomos për shkak të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe procesit dinamik të urbanizimit.

Sidoqoftë, në një vend si Shqipëria, decentralizimi është vetëm gjysma e punës për të shkëlqyer efektet negative të praktikave centralizuese të

trashëguara nga e kaluara. Efektet e plota të decentralizimit do të materializoheshin vetëm nëse do të ndërmerrej edhe një hap tjetër thelbësor, dekokentrimi i pushtetit.

Dekocentrimi i pushtetit zakonisht bëhet në vende që i janë përkushtuar vërtet tërësisht nevojës për të evidentuar qartë dhe në mënyrë trans-

ancimit të zhvillimit rajonal përmes krijimit të një fondi të veçantë të qeverisjes qendrore dhe një koncepti të ri për qeverisjen rajonale dhe ndarjen territoriale. Kjo situatë do të favorizonte riorientimin e proceseve demografike dhe ekonomike në vend, me instrumente zhvillimi in/de/kurajuese dhe stimukimin e de-

prodhimin dhe tipi/niveli i teknologjisë, infrastrukturës dhe shërbimeve.

-Së treti nga shpërndarja e investimeve në vend.

Po të studiojmë historinë e qeverisjes në Shqipëri, do të vemë re një handicap që është krijuar gjatë viteve të ekonomisë së centralizuar dhe që sot kalohet në hesh-tje.

Ky handicap ka të bëjë pikërisht me koncentrimin, një nga karakteristikat më të sofistikuar të centralizimit të pushtetit në Shqipëri gjatë viteve të diktaturës komuniste. Kjo solli eliminimin e një nga niveleve më të rëndësishme balancuese të qeverisjes, atë rajonale.

Diktatura jo vetëm e centralizoi por edhe e koncentroi pushtetin. Si pasojë e saj sot vendi ende vuan nga sëmundja e përqendrimit të tejskajshëm të pushtetit dhe zhvillimit në kryeqytet.

Ky i fundit është i vetmi pol zhvillimi në vend, ndërsa rajonë të tjera dikur të rëndësishme, sot nuk kanë aftësinë e nevojshme për të thithur investime dhe zhvillim, para së gjithash, sepse nuk kanë më si dikur një pjesë reale të instrumente dhe resurseve të pushtetit që sot mbahen me thonj dhe xheloz të madhe në Tiranë. Nëse nuk duam që Shqipëria të jetë baraz me Tiranën, nëse duam ti japim një shans edhe viseve të tjera të

***Dr. Besnik Aliaj është diplomuar në arkitekturë urbanistike, Universiteti i Tiranës në vitin 1990. Ka mbaruar studimet dhe ka marrë gradën master në vitin 1996 dhe doktor i shkencave në vitin 2006. Ka eksperiencë punë në qeverisjen vendore dhe në botën akademike, eksperiencë 10 vjeçare me shoqërinë civile. Është bashkëthemelues dhe ish drejtues i Co-Plan-it (instituti për zhvillimin e habitatit (banimit), sekretar i përgjithshëm i shoqatës së arkitektëve të Shqipërisë, bashkëthemelues i Platformës IDA (instituti për Demokraci dhe reforma), këshilltar për territorin i kryeministrit në vitet 2005-2007, bashkëthemelues dhe rektor i Universitetit "Polis", autor i shumë botimeve profesionale.**

vendit me resurse të lakmueshme, reforma e vërtetë duhet të fokusohet pikërisht tek decentralizimi vertikal drejt pushtetit lokal dhe dekoncentrimi horizontal i pushtetit drejt 3-4 rajoneve, sipas të cilave mund të riorganizohet gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.



parente para opinionit publik strukturat politike dhe ekonomike që dominojnë realisht shoqërinë dhe sidomos mënyrën se si këto struktura politike ushtrojnë kontroll mbi buxhetet e prodhimin dhe shpërndarjen e mirëqenies. Kjo do të rriste kontrollin e interesit publik mbi prodhimin dhe shpërndarjen e burimeve të mirëqenies, duke lehtësuar verifikimin e mënyrës sesi kontrollohen flukset e burimeve materiale dhe financiare ndërmjet tregjeve të ndryshme në vend, dhe efikasitetin e konvertimit të këtyre burimeve nga tregjet ekonomike në ato politike.

Më tej dekoncentrimi i pushtetit do të realizonte një balancim më të mirë midis koncentrimin dhe dekoncentrimit të popullsisë, duke ndihmuar për të përcaktuar nivelin e urbanizimit (sa do të jetë ky 50 apo 70% ?) në të ardhmen, kohëzgjatjen e këtij procesi (15-30 vjet ?), dhe ritmin e tij.

Dekocentrimi do të shërbente më mirë edhe vetë bal-

centralizimit të forcave me karakter ekonomik e gjeopolitik, të cilat gjenerojnë mirëqenie për shoqërinë dhe interesin publik.

Dikush mund të ketë rezerva ndaj dekoncentrimit në një vend të vogël si Shqipëria, me argumentin e shtimit të burokracisë me një nivel më shumë. Në fakt këtu flitet për prezencën më të afërt të shtetit me qytetarët, sidomos në rajonet ku ka nevojë më shumë për këtë prani. Vetë shkalla e dekoncentrimit në vend mund të ketë nivele të ndryshme dhe zgjedhja e këtij niveli, natyrisht është politike, por në thelb ky transferim horizontalpushteti duhet të përcaktohet nga 3 faktorë:

-Së pari, faktorët joekonomikë si demografia (densiteti i popullsisë dhe i zhvillimit), madhësia e vendit dhe topografia.

-Së dyti, faktorët ekonomikë, p.sh. funksioni primar i vendit, (bujqësor, industrial, turistik etj.) , mardhëniet midis sferave të

HAPËSIRA QYTETARE
drejt fundit të tranzicionit?!

Këndvështrime filozofike dhe teknike